

KONTRATË SHËRBIMI

Sot, në datën ___/___/20___, lidhet kjo Kontratë Shërbimi midis:

- **“Albanian Travel and Hospitality Service”(A.T.H.S.)**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS J61826509U, me seli në adresën: Rruga Mine Peza, Tirane, me License Nr. LN-4993-04-2018 si “Operator Turistik”, përfaqësuar nga administratori Z. **Besnik Vathi**, (më tej referuar si **“Ofruesi i Shërbimit”** apo **“Agjencia”**)

DHE

-, i biri i / e bija e, i / e dtl....., lindur në, dhe banues në, me numër tel _____ (më tej referuar si **“Udhëtari”** apo **“Klienti”**).

MEQËNËSE:

- Udhëtari dëshiron dhe është e interesuar të lidhë këtë Kontratë Shërbimi sipas parashikimeve këtu e më poshtë, objekti i së cilës do të përfshijë kryerjen e shërbimeve të parashikuara më poshtë në këtë Kontratë nga Ofruesi i Shërbimit.
- Ofruesi i Shërbimit, i cili operon në fushën e turizmit, shpreh dëshirën dhe angazhimin për të ofruar për Udhëtarin shërbimet e përcaktuara në këtë Kontratë.
- Ofruesi i Shërbimit shpreh vullnetin e tij të mirë për të kryer dhe ndërmarrë kryerjen e shërbimeve në përputhje me këtë Kontratë duke garantuar një përmbushje profesionale dhe të kualifikuar të objektit të saj;
- Udhëtari shpreh vullnetin e tij të mirë dhe pranon shërbimet e ofruara nga Ofruesi i Shërbimit, në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara këtu e më poshtë.

DUKE QENË SE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1. Përkufizime dhe Interpretime

1.1 Termat e përfshirë në këtë Kontratë do të kenë kuptimet e mëposhtme dhe do të interpretohen në përputhje me rrethanat përkatëse, përveç kur Palët kanë rënë dakord ndryshe në lidhje me to:

- **‘Palët’** nënkupton Udhëtarin dhe Ofruesin e Shërbimit, përfshirë vartësit, agjentët ose punonjësit.
- **‘Kontratë Shërbimi’** nënkupton këtë marrëveshje sipas përcaktimeve të mëposhtme (më tej referuar si **‘Kontrata’**);

- **'Data e Fillimit'**, nënkupton datën e parë të fillimit të efekteve të kësaj Kontrate (më tej referuar si **'Data e fillimit'**)
- **'Shërbimet Bazë'** nënkuptojnë shërbime si më poshtë të përcaktuara (më tej referuar si **"Shërbimet Bazë"**).
- **"E drejta e shfrytëzimit ekonomik"** nënkupton të drejta të lidhura me të drejtën e autori mbi veprën (produktet e dorëzuara të shërbimit), sipas parashikimeve të Ligjit 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" përcaktuara (më tej referuar si **"E drejta e shfrytëzimit ekonomik"**).
- **"Paketë Turistike"** – Paketa turistike përkufizohet si përmbledhja e udhëtimit ajror ose tokësor, shëtitjes te ndihmuar nga guida, dhe akomodimit, ne një produkt te njësuar, për te lehtësuar kështu procesin e rezervimit për udhëtarin

Neni 2. Objekti i Kontratës

- 2.1** Objekt i kësaj Kontrate është krijimi dhe rregullimi i marrëdhënieve juridike midis Palëve të kësaj Kontratë, në kuadër të së cilës Ofruesi i Shërbimit do të ofrojë për udhëtarin shërbimin **"Pakete turistike"**
- 2.2** Ofruesi i Shërbimit garanton përmbushjen e Shërbimeve të përcaktuar në pikën më sipër, në përputhje me afatet dhe termat e kësaj Kontrate.

Neni 3. Tarifa e Shërbimit dhe Mënyra e Pagesës

3.1 Shërbimet e kontraktuara sipas objektit të kësaj Kontrate do të kryhen kundrejt tarifës së përcaktuar në Aneksin 1 (*Çmimi*) bashkëlidhur Kontratës. Palët pranojnë dhe deklarojnë se transaksioni tregtar objekt i kësaj Kontrate është subjekt i legjislacionit tatimor të aplikueshëm në Republikën e Shqipërisë dhe secila Palë ka përgjegjësinë e plotë që t'i përmbahet kushteve dhe detyrimeve përkatëse ligjore në përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate.

3.2 Pagesa do të kryhet nga Udhëtari në llogarinë bankare të Ofruesit të Shërbimit e afishuar në aneksin 2, ose cash në filial të A.T.H.S.

3.3 Çmimi do t'i paguhet Ofruesit të Shërbimit brenda para lëshimit të faturës tatimore.

3.4 Afatet e kryerjes së pagesave

Pagesa kryhet sipas kushteve dhe afateve që varen nga lloji i rezervimit dhe nga politikat e furnitorëve përkatës. Klienti njoftohet paraprakisht nga Agjencia për mënyrën e pagesave, afatet dhe kushtet përkatëse, përpara se të vendosë për konfirmimin e rezervimit.

Nëse pagesa nuk përfundon brenda afatit të përcaktuar, A.T.H.S. rezervon të drejtën të pezullojë shërbimet ose të tërhiqet nga kontrata pa paralajmërim. Pagesat e pjesshme të bëra para anulimit ose tërheqjes mund t'i nënshtrohen tarifave jo të rimbursueshme.

Neni 4. Të Drejtat dhe Detyrimet e Udhëtarit

- 4.1** Udhëtari pranon kryerjen e të gjitha Shërbimeve nga Ofruesi i Shërbimit.
- 4.2** Udhëtari do të bashkëpunojë me Ofruesin e Shërbimit kur rezulton e nevojshme për kryerjen e Shërbimeve, në bazë të kërkesës së këtij të fundit ose me iniciativën e vetë Udhëtarit.
- 4.3** Udhëtari do t'i vendosë në dispozicion Ofruesit të Shërbimit të gjitha informacionet e

nevojshme për kryerjen sa më mirë të Shërbimeve sipas Kontratës.

- 4.4** Udhëtari do t'i vendosë në dispozicion Ofruesit të Shërbimit të gjitha të dhënat personale (Emër, mbiemër, datëlindje, fotokopje te pasaportës). Udhëtari mban përgjegjësi për problematikat me dokumentacionin që e bën të pamundur udhëtimin (Pasaporte e skaduar, ose skadence e papranueshme nga shteti pritës).
- 4.5** Udhëtari do të paguaj shumën e plote, siç është parashikuar në aneksin 1, ose të paguaj 50% të Shumës, me kusht që pjesën tjetër ta ketë paguar 2 javë kalendarike para nisjes së udhëtimit.
- 4.6** Udhëtari ka të drejtë të udhëzojë dhe të japë direktiva për Ofruesin e Shërbimit lidhur me përmbushjen e Shërbimeve dhe çështje të tjera të lidhura me to, të cilat mund të ndodhin gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.
- 4.7** Udhëtari rezervon të drejtën që të kërkojë nga Ofruesi i Shërbimit përsëritjen e Shërbimit, në rast se ky i fundit nuk përmbush kërkesat e Udhëtarit për të realizuar Shërbimin në përputhje me objektin e kontratës, si edhe nëse nuk janë përmbushur në zbatimin e shërbimit direktivat e dhëna nga udhëtari sipas parashikimeve të pikës 4.4 të këtij Neni, duke përcaktuar me shkrim një afat për përgatitjen e tyre.

Neni 5. Të Drejtat dhe Detyrimet e Ofruesit të Shërbimit

- 5.1** Ofruesi i Shërbimit do të kryejë Shërbimet në përputhje me Nenin 2 të kësaj Kontrate dhe kushtet e tjera të kësaj të fundit.
- 5.2** Ofruesi i Shërbimit do të kryejë Shërbimet, në një mënyrë tërësisht profesionale dhe kompetente, duke përdorur të gjitha kapacitetet e tij të burimeve njerëzore.
- 5.3** Ofruesi i Shërbimit do të marrë parasysh dhe do të zbatojë kërkesat e Udhëtarit në lidhje me të gjitha specifikat dhe kërkesat e kryerjes së shërbimeve të paraqitura nga kjo e fundit.
- 5.4** Ofruesi i Shërbimit është i detyruar të kontaktojë drejtpërdrejtë me personin përgjegjës për fëmijën që nuk është i shoqëruar nga prindërit apo përfaqësuesin e tij ligjor.

Neni 6. Kohëzgjatja dhe Përfundimi i Kontratës

- 6.1** Kjo Kontratë hyn në fuqi dhe fillon efektet e saj me nënshkrimin e kontratës nga Palët deri në rikthimin e udhëtarit.
- 6.2** Secila Palë mund të përfundojë këtë Kontratë duke njoftuar Palën tjetër në formë të shkruar të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara për shkaqe të arsyeshme.
- 6.3** Kjo Kontratë mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga Udhëtari në rast se (i) nuk ka nisur ekzekutimi i shërbimit për më shumë se 1 (një) javë nga nënshkrimi i saj; (ii) nuk janë respektuar detyrimet e Ofruesit të Shërbimit, të përcaktuara në këtë Kontratë (iii) nëse pala tjetër nuk ka mundësi të përmbushë detyrimet e kësaj kontrate për shkak se është në proces falimentimi, procedura likuidimi, objekt i një vendimi gjykatë apo i një vendimi administrativ. Gjithashtu Udhëtari do të njoftohet në rastin e anulimit të të turit nga ana e operatorit të paktën një 1 (një) javë përpara datës së nisjes së udhëtimit.

6.4 Përfundimi i marrëdhënieve kontraktuale që rrjedhin nga kjo Kontratë, për çfarëdo lloj arsye, nuk do të ndikojë në ndonjë të drejtë të fituar tashmë ose përgjegjësi të lindur të secilës Palë ose hyrjen në fuqi ose vazhdimin e efekteve të ndonjë prej parashikimeve të kësaj Kontrate, për të cilën është rënë dakord në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar që të jetë në fuqi gjatë ose pas përfundimit të saj.

6.5 Ndryshimet dhe anulimet kërkojnë njoftim paraprak tek A.T.H.S. Secili shërbim brenda paketës (fluturim, hotel, transferim) trajtohet në mënyrë të pavarur dhe i nënshtrohet politikave të vet furnitorit. Ndryshimet ose anulimet për një shërbim nuk ndikojnë automatikisht në të tjerët. Klientët duhet të kuptojnë dhe respektojnë politikat individuale për çdo shërbim.

Neni 7. Garanci dhe të drejtat e Pronësisë Intelektuale

7.1 Ofruesi i Shërbimit garanton si më poshtë:

- a) kryerjen e Shërbimeve me kujdes, profesionalizëm dhe cilësi;
- b) kryerjen e Shërbimeve në zbatim të kushteve dhe termave të kësaj Kontrate;
- c) mbrojtjen e dhe veprimin në interesin më të mirë të Udhëtarit gjatë kryerjes së Shërbimeve;

Neni 8 . Pronësia intelektuale

8.1 Ofruesi i Shërbimit garanton se shërbimet dhe materialet e ofruara për Udhëtarin në zbatim të këtij Kontrate nuk do të cenojë ose shkelë të drejta të pronësisë intelektuale ose të drejta të tjera titullarë të të cilave janë palë të treta. Gjithashtu, çdo dokument, informacion apo material që i ofrohet atij nga udhëtari do të mbetet pronë e udhëtarit, duke përfshirë (por pa u kufizuar në të) të drejtat e autorit, patentat, të drejtat e sekretit tregtar dhe të drejta të tjera të pronësisë intelektuale që lidhen me ndonjë ide, konceptet, teknikat, shpikjet, proceset, veprat e autorësisë, Informacioni Konfidencial ose sekretet tregtare.

8.2 Pas përfundimit të afatit të kësaj kontrate, Ofruesi i Shërbimit do të përmbahet nga përdorimi i pronës intelektuale.

Neni 9. Forca Madhore

9.1 Asnjë nga Palët nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë mos përmbushje ose vonesë të përmbushjes së detyrimeve kontraktore, që shkaktohen nga Forca Madhore si katastrofa natyrore, tërmete, luftëra, akte sabotimi, greva, kryengritja, trazira si dhe ndalime ose kufizime ligjore ose nxjerrja e akteve nënligjore të cilat pengojnë ose kufizojnë përmbushjen e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë në një nivel të konsiderueshëm si dhe defekte teknike të rënda ose ndërprerje të përgjithshme të energjisë elektrike.

9.2 Vonesat në përmbushjen e detyrimeve ose mos përmbushje të tyre nga ana e njërit palë nuk e legjitimojnë palën tjetër të përfundojë marrëdhënien kontraktuale nëse një mos përmbushje e tillë ka ardhur si rezultat i shkaqeve të përcaktuara në pikën 9.1 të kësaj Kontrate.

Neni 10. Përgjegjshmëria

- 10.1 Ofruesi i Shërbimit garanton përmbushjen dhe kryerjen e Shërbimeve në afatin e duhur dhe në një mënyrë të kujdesshme dhe kompetente në bazë të rregullave dhe standardeve të praktikave më të mira të pranuar.
- 10.2 Ofruesi i Shërbimit është përgjegjës për ndonjë mos përmbushje në kohë të Shërbimeve, për një mos përmbushje të tillë ai duhet të paguajë një penaltet prej 2% të Tarifës së Shërbimit për çdo ditë vonesë. Pagesa e penaltetit sipas kësaj pike paguhet nga Ofruesi i Shërbimit brenda 10 ditëve nga njoftimi i Udhëtarit dhe përbën titull ekzekutiv.

Neni 11. Komunikimi

- 11.1 Kur njëra nga palët e kësaj Kontrate detyrohet ose është e legjitimuar të njoftojë ose drejtojë tek pala tjetër, ose të paraqesë një kërkesë ose lutje, këto të fundit duhet të paraqiten në formë të shkruar dhe do të konsiderohen se janë dorëzuar nëse dërgohen dorazi tek personi tek i cili janë drejtuar ose nëse dërgohen nëpërmjet rrugës elektronike (e-mail) tek pala së cilës i referohen në adresën e mëposhtme ose atë të ndryshuar përkatësisht, duke marrë të mirëqenë se një ndryshim i tillë i është njoftuar palës tjetër në mënyrat e përcaktuara në këtë nen. Komunikimet do të adresohen si më poshtë:

Ofruesi i Shërbimit:

Ne vëmendje te: _____

E-mail: _____

Telefon: _____

Udhëtari:

Ne vëmendje te: _____

E-mail: _____

Neni 12. Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 12.1 Kjo Kontratë zbatohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 12.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Kontrate, nëse nuk do të zgjidhet miqësisht mes palëve, ato mund t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 12.3 Termat dhe kushtet e përcaktuara këtu përbëjnë marrëveshjen e plotë midis palëve dhe mund të ndryshohen ose shtohen vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga Palët.

Neni 13. Dispozita përfundimtare

- 13.1 Kontrata zëvendëson çdo lloj korrespondence të mëparshme të mbajtur midis Palëve. Kjo Kontratë mbizotëron mbi çdo term ose detyrim tjetër ose ndonjë dokument tjetër që është pranuar nga palët.
- 13.2 Marrëveshjet jo-formale janë të vlefshme vetëm nëse materializohen në formë të shkruar.
- 13.3 Mosekzekutimi i ndonjë të drejtë të rrjedhur nga Kontrata nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga kjo e fundit.
- 13.4 Në rast se ndonjë nga dispozitat e Marrëveshjes ose pjesë e saj është ose shpallet e pavlefshme, nuk do të cenohet vlefshmëria e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila duhet të ketë një kuptim dhe qëllim të njëjtë ose të përafërt me atë të dispozitës së pavlefshme.

Kjo Kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga secila prej Palëve dhe përpilohet në 2 (dy) njësi origjinale, në gjuhën shqipe, me vlefshmëri të njëjtë secila, nga një për secilën palë.

UDHETARI

OFRUESI SHERBIMIT

**Besnik
Vathi**



Digitally signed by Besnik Vathi
Date: 2026.04.16 11:49:53 +02'00'

Shtojca 1

Kontratë sigurimi për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, përfshirë aftësinë paguese dhe falimentin.

Shtojca 2

Programi i detajuar i udhëtimit përkatës, bashkëlidhur kësaj kontrate, përbën pjesë integrale dhe të pandashme të saj.

Policë Sigurimi Përgjegjësi Publike ndaj palëve të treta Nr. 264200233

Shoqëria e sigurimit SIGAL INSURANCE Group Sh.a., me adresë Qendra e Biznesit SIGAL, Blvd. "Zog I", Nr. 1, Tiranë, në përputhje me kushtet, përcaktimet, përjashtimet dhe parashikimet e Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Përgjegjësive Publike dhe kësaj Police, do të dëmshpërblejë ALBANIAN TRAVEL AND HOSPITALITY SERVICE(A.T.H.S.), me adresë: AL dhe NUIS: J61826509U për të gjithë shumën e cila është ligjrisht e detyrueshme për zhdëmtimin e shpenzimeve dhe kostove të pretenduesit për çdo ngjarje të siguruar për të cilën aplikohet kjo policë dhe brenda limiteve të zhdëmtimit si më poshtë për dëmtime materiale dhe dëmtime trupore (përfshirë vdekjen dhe / ose sëmundjen dhe / ose të personit të tretë kundrejt pagesës së primit të sigurimit prej:

Primi Neto: **5,000.00 Lekë** plus Taksa e primit **500.00 Lekë**;

Pagesa Totale: **5,500.00 Lekë** prim është i pagueshëm brenda 15 ditëve nga data e fillimit të Sigurimit.

Me kusht që përgjegjësia e SIGAL INSURANCE Group SH.A. për këtë Policë të mos kalojë limitet:

Limitet e Dëmshpërblimit

Limti i Dëmshpërblimit

Për Dëmtime Trupore dhe Dëmtime Materiale

- ❖ Për çdo ngjarje: 1,000,000.00 Lekë
- ❖ Në agregat për të gjithë periudhen e sigurimit: 2,000,000.00 Lekë

Pjesa e Zbritshme (për çdo ngjarje): 10.00% e cdo dëmi, min 20,000.00 Lekë

Periudha e Sigurimit: Nga ora 24.00 datë: 15/04/2026

Deri ora 24.00 datë: 14/04/2027

Territori i Mbulimit: Ne ambientet e agjensise ALBANIAN TRAVEL AND HOSPITALITY SERVICE (A.T.H.S.) me adrese: Njesia Nr.9 Rruga Mine Peza Numer Pasurie 6/43-N8 Zona Kadastrale 8350 Volumi 20 faqe 4 , Tirane sipas dokumentacionit bashkengjitur.

Mbulim shtesë: Falimenti. Kjo policë do të mbulojë edhe kërkesat për dëmshpërblim për vonesat nga ana e të Siguruarit në respektimin e detyrimeve dhe kompensimeve që lidhen me zbatimin e kësaj kontrate nga i siguruari si pasoje e Falimentit të tij. Limiti i Përgjegjësive së këtij seksioni është brenda Limitit të Përgjithshëm të Përgjegjësive më lart.

Përjashtimet Kryesore: Përjashtohen çdo përgjegjësi që rrjedh nga ndotja, përgjegjësia e produktit dhe përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve në kushtet bashkangjitur.

Lëshuar në Tiranë më: 14/04/2026

Për sa mësipër nënshkruajnë personat e mëposhtëm:

I SIGURUARI

Agjenti/Dega

Eledia Mullaj

ALBANIAN TRAVEL AND HOSPITALITY SERVICE (A.T.H.S.) SHPK
SERVICE (A.T.H.S.) 61826509U
Rruga Mine Peza, Tirana - Albania

SIGURUESI
SIGAL
IG Insurance Group
Administratë e Përgjithshme
DREKTORIA E QIESHES SIGURIM
UNDERWRITING DEPARTMENT




**KUSHTET STANDARDE TË SIGURIMIT
TË PËRGJEGJËSISË PUBLIKE**

**STANDARD TERMS OF PUBLIC LIABILITY
INSURANCE**

Përmbajtja

Contents

- | | | |
|-------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| I. | Percaktimet | I. Definitions |
| II. | Mbulimi në sigurim | II. Insurance Coverage |
| III. | Objekti i sigurimit | III. Object of the Insurance |
| IV. | Ngjarja e Sigurimit | IV. Insurance Event |
| V. | Kufijtë e përgjegjësive së siguruesit | V. Limits of the Insurer's Liability |
| VI. | Kufijtë territorialë / Juridiksioni | VI. Territorial Limits / Jurisdiction |
| VII. | Përjashtime | VII. Exclusions |
| VIII. | Parashikime të tjera | VIII. Other Provisions |
| IX. | Detyrime të palëve në policë | IX. Obligations of the Policy Parties |
| X. | Parashikime të përgjithshme | X. General Provisions |
| XI. | Parashikime të veçanta | XI. Special Provisions |
| XII. | Periudha e policës së sigurimit | XII. Insurance Policy Period |



I. Përcaktimet

Percaktimet e mëposhtme u janë bashkangjitur kushteve ekzistuese:

Sigurimi: kontrate sigurimi;

SIGAL INSURANCE Group: kompani sigurimi, si Sigurues;

I Siguruari: Subjekti i siguar;

Kontraktori/Policëmbajtësi: personi me të cilin SIGAL INSURANCE Group SH.A. konkludon marrëveshjen e sigurimit, edhe nëse ky është një person i ndryshëm nga I Siguruari;

Perfituesi: Subjekti tek i cili paguhet dëmshperblim, edhe nëse ky është i ndryshëm nga I Siguruari.

Shuma e siguar: Limiti maksimal që SIGAL INSURANCE Group SH.A. është i detyruar për të paguar në rast ndodhje demigjate periudhes së siguar;

Demshperblimi: Shuma që SIGAL INSURANCE Group SH.A i detyrohet të Siguarit/Perfituesit në rast ndodhje demigjate;

Risk: mundësia e ndodhjes së rasteve që rezultojnë në dëm;

Prim i sigurimit: shuma që i Siguruari paguan për risqet që Siguruesi merr për të mbuluar;

Police: dokument i nënshkruar nga palët, i cili përfaqëson një kontratë Sigurimi si dhe kushtet e sigurimit;

Ngjarje e siguar: ngjarje e përcaktuar në kushtet kontraktuale ndodhja e së cilës shkakton dëm tek i Siguruari;

Pjesë e zbritshme: pjesë e dëmit mbuluar nga I siguruari për çdo dëm dhe çdo ngjarje prioritare kundrejt pagesës detyruese të kompanisë së sigurimit.

I. Definitions

The following definitions are added to the existing terms:

Insurance: Insurance contract;

SIGAL INSURANCE INSURANCE Group: Insurance company, as the Insurer;

The Insured: The insured entity;

Contractor/Policyholder: The person with whom SIGAL INSURANCE Group SH.A. concludes the insurance agreement, even if this person is different from the Insured;

Beneficiary: The entity to whom the compensation is paid, even if different from the Insured;

Sum Insured: The maximum limit that SIGAL INSURANCE Group SH.A. is obliged to pay in case of damage during the insured period;

Compensation: The amount that SIGAL INSURANCE Group SH.A owes to the Insured/Beneficiary in case of damage;

Risk: The possibility of occurrences that result in damages;

Insurance Premium: The amount paid by the Insured for the risks that the Insurer agrees to cover;

Policy: A document signed by the parties, representing an Insurance contract and the terms of the insurance;

Insured Event: An event specified in the contractual terms whose occurrence causes damage to the Insured;

Deductible: The part of the damage covered by the Insured for each damage and each prior event against the mandatory payment of the insurance company.

II. Insurance Coverage

II. Mbulimi në sigurim

Shoqëria e sigurimit SIGAL INSURANCE Group SH.A. (që këtu më poshtë do të quhet siguruesi), në përputhje me këto kushte, kufijtë e mbulimit në sigurim të përcaktuar në formular, do të jetë ligjërishit përgjegjëse të dëmshpërblejë të siguruarit për periudhën e përcaktuar në formularin e kësaj police të sigurimit dhe kundrejt pagesës së primit të sigurimit nga i siguruari sipas përcaktimeve në këtë formular:

1. për shumat për të cilat i Siguruari do të jetë ligjërishit përgjegjës të paguajë si kompensim dëmi kundrejt palës së dëmtuar për mbulimin e dëmeve që mund të shkaktohen ndaj jetës, shëndetit dhe pronës të palëve të treta ne ambientet e tij/saj dhe shpenzime të tjera që rezultojnë nga ngjarja e sigurimit për të cilën është e zbatueshme kjo Kontratë Sigurimi, brenda kufijve të përgjegjësive të përcaktuara në Kontratën e Sigurimit.
2. për shpenzimet e mbrojtjes ligjore të kryera me miratimin paraprak me shkrim të siguruesit, në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim ndaj të siguruarit, për të cilën zbatohen kushtet e kësaj Kontrate sigurimi kundrejt pagesës së primit të sigurimit:

III. Objekti i Sigurimit

I Siguruari i përcaktuar në formularin e kësaj police të sigurimit është

a. Personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, që zhvillojnë veprimtarinë turistike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, veprojnë në përputhje me Ligjin Nr. 30/2024, datë 04.04.2024 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 93/2015, "Për turizimin", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b. Personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari turistike biznesi, në baza kontraktuale, jashtë territorit të Republikës

The insurance company SIGAL INSURANCE Group SH.A. (hereinafter referred to as the insurer), in accordance with these terms, the coverage limits defined in the form, shall be legally responsible to compensate the insured for the period defined in the form of this insurance policy and against the payment of the insurance premium by the insured according to the definitions in this form:

1. For amounts for which the Insured will be legally liable to pay as damage compensation to the injured party for covering damages that may be caused to the life, health, and property of third parties in his/her premises and other expenses resulting from the insured event to which this Insurance Contract is applicable, within the liability limits defined in the Insurance Contract.
2. For legal defense expenses incurred with the prior written approval of the insurer, related to the claim for compensation against the insured, for which the conditions of this Insurance Contract apply against the payment of the insurance premium.

III. Object of the Insurance

The Insured specified in the form of this insurance policy is.

a. Legal and fiscal persons, local or foreign, engaged in tourist activities within the territory of the Republic of Albania, operating in accordance with Law No. 30/2024, dated 04.04.2024, amending and supplementing Law No. 93/2015, 'On tourism', as amended, and the subordinate legislation issued thereunder, as well as provisions of international agreements to which the Republic of Albania is a party;

b. Natural and legal persons engaged in business tourist activities on a contractual basis outside the territory of the Republic of Albania, operating in accordance with the

së Shqipërisë, vepronë në përputhje me dispozitat Ligjin Nr. 30/2024, datë 04.04.2024 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 93/2015, "Për turizimin", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, për sa kohë që ato nuk bien në kundërshtim me ligjin e vendit ku zhvillohen këto veprimtari.

2. Kjo policë sigurimi mbulon vetëm përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara palëve të treta në ambientin e strukturës akomoduese apo operatorit turistik në përputhje me Ligjin Nr. 30/2024, datë 04.04.2024 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 93/2015, "Për turizimin", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij

IV. Ngjarja e Sigurimit

Nëpërmjet kësaj, Siguruesi bie dakord, në shkallën dhe mënyrën e dhënë si më poshtë, të dëmshpërblejë të Siguruarin deri në, por jo më shumë se shuma e përcaktuar në Policë kundrejt një shume të tillë që I Siguruarit është ligjërisht i detyruar të paguajë lidhur me pretendimet e ngritura kundër të Siguruarit si pasojë e dëmtimit trupor ose sëmundjeve (fatale ose jo fatale) të personave (tani e tutje të quajtura dëmtime trupore) ose dëmtimeve të pasurisë të shkaktuara nga një aksident i ndodhur gjatë periudhës së përcaktuar në Formular në ose pranë vendit (ve) të përcaktuara në Policë.

V. Kufijtë e përgjegjësisë së siguruesit

1. Përgjegjësia e siguruesit për kostot e kompensimit dhe shpenzimet e pagueshme kundrejt një ose disa të dëmtuarve si rrjedhojë e një ngjarjeje sigurimi nuk do të kalojë shumën e përcaktuar në formular si 'kufi maksimal i mbulimit në sigurim për çdo ngjarje'.

Të gjitha dëmet që janë pasojë e ekspozimit të vijueshëm, ose të përsëritur të të njëjtave kushte dëmtuese të të njëjtës ngjarje në të cilën ka ndodhur dëmi i parë, do të konsiderohen një ngjarje e vetme.

provisions of Law No. 30/2024, dated 04.04.2024, amending and supplementing Law No. 93/2015, 'On tourism', as amended, and the subordinate legislation issued thereunder, for as long as such activities do not contravene the laws of the country where these activities are conducted..

This insurance policy covers only liability for damages caused to third parties within the premises of the accommodation structure or touristic operator in accordance with Law No. 30/2024, dated 04.04.2024, amending and supplementing Law No. 93/2015, 'On tourism', as amended, and the subordinate legislation issued thereunder.

IV. Insurance Event

Through this, the Insurer agrees, to the extent and manner specified below, to indemnify the Insured up to, but not exceeding, the amount specified in the Policy, against such sums as the Insured is legally obligated to pay in respect of claims made against the Insured arising from bodily injury or illnesses (fatal or non-fatal) to persons (hereinafter referred to as bodily injury) or damage to property caused by an accident occurring during the period specified in the Form at or near the place(s) specified in the Policy..

V. Limits of the Insurer's Liability

1.The insurer's liability for compensation costs and expenses payable to one or several injured parties as a result of an insured event shall not exceed the amount specified in the form as 'maximum insurance coverage limit per event'.

All damages resulting from continuous or repeated exposure to the same damaging conditions of the same event in which the first damage occurred shall be considered a single event.

2.The insurer's liability for all compensation

2. Përgjegjësia e siguruesit për të gjithë kostot e kompensimit dhe shpenzimet e pagueshme në lidhje me të gjitha ngjarjet e sigurimit që ndodhin gjatë një periudhe sigurimi nuk do të kalojë shumë e përcaktuar në formular si kufi agregat vjetor.

VI. Kufijtë territorialë / Juridiksioni

Territori i Policës nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo police vepron nën ligjin / juridiksionin Shqiptar.

VII. Përjashtime

Kjo policë nuk mbulon:

1. përgjegjësinë që lidhet me dëmtimet shëndetësore, plagosjet apo sëmundjet e palëve që kanë një kontratë pune, ose praktike mësimore me të siguruarin, e personave të punësuar nga i siguruari, në rastin kur dëmtimi shëndetësor, plagosja apo sëmundja vjen si rrjedhojë e zbatimit të kontratës së punës, kontratës mësimore, apo punësimit të tyre;
2. dëmtimet trupore ose dëmet pasurore që shkaktohen nga lëndë ose materiale të prodhuara, ndërthuara, ndryshuara, shërbyera, trajtuara, shitura, furnizuara apo shpërndara nga i siguruari (përgjegjësia e produktit), që nga çasti që këto nuk janë më në posedimin apo nën kontrollin e të siguruarit;
3. përgjegjësinë nga përdorimi i mjetit motorik që është objekt i sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive motorrike sipas legjislacionit në fuqi, në rast se ky mjet motorik është në pronësi të të siguruarit, merret me qera, merret borxh, merret me leasing, apo përdoret nga i siguruari, apo nga personi që kërkon dëmshpërblim;
4. përgjegjësinë e anijeve apo avionëve, në rast se ato janë në pronësi, merren me qera, merren borxh, merren me leasing, apo përdoren nga i siguruari;
5. përgjegjësinë për humbjet financiare që nuk janë rrjedhim i dëmtimeve të pronës, apo dëmtimeve shëndetësore të përcaktuara në seksionin II të këtyre kushteve.
6. çdo përgjegjësi të cfarëdo natyre të

costs and expenses payable related to all insured events occurring during an insurance period shall not exceed the amount specified in the form as the annual aggregate limit.

VI. Territorial Limits / Jurisdiction

The territory of the Policy means the territory of the Republic of Albania. This policy operates under Albanian law/jurisdiction.

VII. Exclusions

This policy does not cover:

1. Liability related to health damages, injuries, or illnesses of parties who have an employment or internship contract with the insured, or persons employed by the insured when the health damage, injury, or illness is a result of the employment contract, internship contract, or their employment;
2. Bodily injuries or property damages caused by substances or materials produced, built, altered, serviced, treated, sold, supplied, or distributed by the insured (product liability), from the moment these are no longer in the possession or under the control of the insured;
3. Liability from the use of a motor vehicle that is subject to mandatory motor liability insurance according to the legislation in force, if this motor vehicle is owned by the insured, rented, borrowed, leased, or used by the insured or by the person claiming compensation;
4. Liability for ships or aircraft, if they are owned, rented, borrowed, leased, or used by the insured;
5. Liability for financial losses that are not a result of property damage or health damages specified in section II of these terms;
6. Any liability of any nature caused directly or indirectly, or influenced by air, water, and soil

shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, apo të ndikuar nga ndotja e ajrit, ujit dhe dheut.

7. përgjegjësinë për dëmet dhe dëmtimet e pronës:

- a. që i përkasin të siguruarit;
- b. që ndërtohet apo është nën kujdesin, ruajtjen, apo kontrollin e të siguruarit apo të personave të punësuar, apo që punojnë për llogari të të siguruarit.

8. kërkesat për dëmshpërblim për vonesat në respektimin e detyrimeve dhe kompensimet që lidhen me zbatimin e kontratave të ndryshme nga kjo policë e sigurimit.

9. përgjegjësinë që lidhet me ngjarje që rezultojnë nga veprime, ose mosveprime të qëllimshme apo të pandershme të të siguruarit.

10. përgjegjësitë e marra përsipër nga i siguruari nëpërmjet kontratave ose marrëveshjeve të tjera, garancitë e dhëna nga i siguruari që rritin përgjegjësinë ligjore të të siguruarit, përveç rasteve kur i siguruari do të ishte përgjegjës edhe në mungesë të këtyre kontratave, marrëveshjeve apo garancive.

11. çdo përgjegjësi të çfarëdolloj natyre të shkaktuar direkt apo indirekt nga:

- a. rrezatimi jonizues apo ndotja radioaktive nga lëndë bërthamore ose mbetje bërthamore;
- b. vetitë radioaktive, helmuese, shpërthyes ose veti të tjera të dëmshme të materialeve, ose përbërësve bërthamorë.

12. përgjegjësitë që rezultojnë nga asbesti ose sëmundje të lidhura me të (përfshirë kancerin), që janë pasojë e ekzistencës, prodhimit, trajtimit, përpunimit, shitjes, shpërndarjes, magazinimit ose përdorimit të asbestit, prodhimeve të azbestit dhe/ose prodhimeve që përmbajnë asbest;

13. përgjegjësinë për pasojat e luftës, aktit të pushtimit nga armiq të huaj (pavarësisht nëse lufta deklarohet, ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, grushtit të shtetit, forcës ushtarake, terrorizmit, vandalizmit, akteve keqdashëse, apo sabotazhit;

14. dëmet nga gjobat, penaltitetet, masat korrektuese që nuk lidhen me këtë policë sigurimi;

pollution;

7.Liability for property damages:

- a. belonging to the insured;
- b. being built or under the care, custody, or control of the insured or the persons employed or working on behalf of the insured;

8.Claims for compensation for delays in fulfilling obligations and compensations related to the implementation of contracts other than this insurance policy;

9.Liability related to events resulting from deliberate or dishonest actions or omissions by the insured;

10.Liabilities assumed by the insured through contracts or other agreements, guarantees given by the insured that increase the insured's legal liability, except where the insured would be liable even in the absence of these contracts, agreements, or guarantees;

11.Any liability of any kind caused directly or indirectly by:

- a. ionizing radiation or radioactive contamination from nuclear materials or nuclear waste;
- b. radioactive, toxic, explosive, or other harmful properties of nuclear materials or components.

12.Liabilities resulting from asbestos or related diseases (including cancer) caused by the existence, production, processing, handling, sale, distribution, storage, or use of asbestos, asbestos products, and/or products containing asbestos;

13.Liability for war consequences, acts of invasion by foreign enemies (whether or not war is declared), civil war, rebellion, revolution, coup d'état, military force, terrorism, vandalism, malicious acts, or sabotage;

14.Damages from fines, penalties, corrective measures not related to this insurance policy;

15.Damages resulting from non-compliance

15. dëmet që janë rrjedhojë e moszbatimit të rregullave për ruajtjen e materialeve të djegshëm apo eksplozivë;

16. dëmet që rrjedhin nga aktivitete që nuk parashikohen në mënyrë të veçantë në mbulimet e kësaj police, veçanërisht përgjegjësia që vjen nga:

a. aktivitete, apo marrëdhënie ligjore që nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e të siguarit dhe as me rrezikun e siguar.

b. prodhimi, përpunimi, transportimi ruajtja e eksplozivëve për çdo qëllim.

c. pronësia apo përdorimi i hekurudhave për të transportuar mallra / lëndë në ambientin e punës.

17. siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për demshpërblim ose të japë ndonjë përfitim sipas kësaj kontrate, nëse ofrimi i një mbulimi të tillë, pagesa e një kërkesë të tillë ose dhënia e një përfitimi të tillë do të ekspozonte Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi, sipas Rezolutave të Kombeve të Bashkuara ose sanksioneve tregtare ose ekonomike, ligjeve ose rregulloreve të Bashkimit Europian, gjithashtu sipas Ligjit Shqiptar, Mbretërisë së Bashkuar ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës;

18. përgjegjësine nga sulmet kibernetike, i cili nënkupton çdo rrezik të humbjes financiare, ndërprerjes ose dëmtimit të reputacionit të një organizate nga një lloj dështimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit. Ky sigurim ne asnjë rast nuk mbulon humbje, demtime, përgjegjesi apo shpenzime të shkaktuara ose të ndikuara direkt ose indirekt që rrjedhin nga përdorimi si mjet për të shkaktuar dëm i cdo kompjuteri, sistemi kompjuterik, programi soft kompjuterash, kode keqdashës, virusesh kompjuterike ose cdo sistemi tjetër apo paisje tjetër elektronike.

19. cdo dëm që lidhet me dëme trupore (përfshirë Stresin Emocional ose traumën mendore ose fobinë), cdo lloj demesh ose humbesh materiale, të cilat janë ose pretendohet të jenë shkaktuar nga, të ndikuara nga ose në cdo mënyrë të lidhura me:

Sindromen e fituar të imunitetit të ulur (SIDA/AIDS) ose agjenteve patologjike të tij ose hepatiti;

with the rules for storing flammable or explosive materials;

16. Damages resulting from activities not specifically foreseen in the coverage of this policy, especially liability arising from:

a. activities or legal relations not related to the insured's activity and the insured risk.

b. production, processing, transportation, storage of explosives for any purpose.

c. ownership or use of railways for transporting goods/substances in the workplace.

17. The insurer will not be obliged to pay any compensation claim or provide any benefit under this contract if providing such coverage, payment of such a claim, or providing such a benefit would expose the insurer to any sanction, prohibition, or restriction, under the Resolutions of the United Nations or trade or economic sanctions, laws, or regulations of the European Union, as well as Albanian law, the United Kingdom, or the United States of America;

18. Liability from cyber-attacks, which means any risk of financial loss, interruption, or damage to the reputation of an organization from any type of failure of information technology systems. This insurance in no case covers losses, damages, liabilities, or expenses caused or influenced directly or indirectly arising from the use as a means to cause damage of any computer, computer system, computer software, malicious code, computer viruses, or any other system or other electronic devices.

19. Any damage related to bodily injuries (including emotional stress or mental trauma or phobia), any kind of material damages or losses, which are or are claimed to be caused by, influenced by, or in any way related to:

Acquired Immunodeficiency Syndrome (AIDS) or its pathological agents or hepatitis;

Infectious diseases: Infectious disease will be

Semundjet ngjitesë: Me semundje ngjitesë do të kuptohet çdo semundje, e cila mund të transmetohet midis njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose me anë të ndonjë substancë ose agjenti nga ndonjë organizëm në një organizëm tjetër, kur:

- substancë ose agjenti përfshin, por nuk kufizohet vetëm në një virus, bakter, parazit ose organizëm tjetër ose ndonjë ndryshim të tij, qoftë ai që konsiderohet i gjallë ose jo, dhe
 - metoda e transmetimit, qoftë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, përfshin por nuk është e kufizuar në, transmetimin në ajër, transmetimin e lëngjeve trupore, transmetimin nga ose në ndonjë sipërfaqe ose objekt, të ngurtë, të lëngshëm ose gaz ose midis organizmave, dhe
 - sëmundja, substancë ose agjenti mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin e shëndetit të njeriut ose të mirëqenies njerëzore ose mund të shkaktojë ose kërcënojë dëm, përkeqësim, humbje të vlerës së, tregtueshmërinë ose humbjen e përdorimit të pasurisë;
20. Çdo lloj dëmi direkt/indirekt apo të vazhdueshëm/gradual që i shkaktohet mjedisit;

VIII. Parashikime të tjera.

1. Detyrimi i siguruesit për dëmshpërblim kufizohet në përqindjen e pjesës së të siguarit në grupin e ndërrmarjes së përbashkët, pavarësisht se të cilës shoqëri partnere janë personat, apo pronat përgjegjëse për shkaktimin e dëmit.
2. Dëmet që u shkaktohen sendeve të sjella nga partnerët në ndërrmarjen e përbashkët me të siguarin përjashtohen nga ky mbulim në sigurim, pavarësisht nga fakti se kush është përgjegjës për dëmin.
3. Dëmet që i shkaktohen një partneri të ndërrmarjes së përbashkët nga partnerë të tjerë të ndërrmarjes, apo anasjelltas, përjashtohen nga ky mbulim në sigurim

IX. Detyrime të palëve në policë

understood as any disease that can be transmitted between people, animals, or plants, or through any substance or agent from one organism to another, where:

-The substance or agent includes, but is not limited to a virus, bacterium, parasite, or other organism or any variation thereof, whether it is considered alive or not, and

-The method of transmission, whether direct or indirect, includes but is not limited to, transmission in the air, transmission of bodily fluids, transmission from or to any surface or object, solid, liquid, or gas or between organisms, and

-The disease, substance, or agent may cause or threaten damage to human health or well-being or may cause or threaten damage, deterioration, loss of value, marketability, or use of property.

20. This clause indicates that the insurance policy does not cover any type of environmental damage, whether it is direct or indirect, or occurs continuously or gradually.

VIII. Other Provisions

1. The insurer's liability for compensation is limited to the insured's percentage share in the joint venture, regardless of which partner company's persons or properties are responsible for causing the damage.
2. Damages caused to items brought by partners into the joint venture with the insured are excluded from this insurance coverage, regardless of who is responsible for the damage.
3. Damages caused to a partner in the joint venture by other partners, or vice versa, are excluded from this insurance coverage.

IX. Obligations of the parties to the policy

1. The insured must take all necessary steps

1. I siguruari duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për parandalimin dhe minimizimin e dëmeve shëndetësore, apo dëmtimeve të tjera që mund të çojnë në kërkesa për dëmshpërblim sipas kushteve të kësaj police të sigurimit dhe zbaton të gjitha masat dhe rregullat e sigurimit teknik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

2. Çdo ngjarje që mund të çojë në kërkesë për dëmshpërblim sipas kësaj police të sigurimit, duhet të raportohet me shkrim nga i siguruari tek siguruesi menjëherë pas ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Brenda mundësive, nuk duhet të kryhet asnjë lëvizje apo riparim deri sa siguruesi të mund të kryejë investigimin. I siguruari duhet të njoftojë siguruesin menjëherë për çdo proces të mundshëm penal apo civil që lidhet me ngjarjen dhe duhet t'i dërgojë atij menjëherë të gjithë dokumentat përkatëse.

3. Asnjë pranim i përgjegjesisë, premtim për ofertë, apo pagesë nuk duhet bërë pa miratimin me shkrim nga siguruesi. Siguruesi do të ketë të drejtën të marrë përsipër dhe të kryejë në emër të të siguarit mbrojtjen, ose pagesën e çdo dëmi që rezulton nga ngjarja e siguar dhe të ndjekë në rrugë ligjore kërkesën për subrogim nga persona të tjerë. I siguruari duhet të japë të gjithë informacionin dhe asistencën që i kërkohet nga siguruesi.

4. Siguruesi mund të paguajë shumën maksimale të pagueshme për ngjarje e sigurimit që mbulohet nga polica e sigurimit, ose një shumë më të vogël me të cilën mund të mbulohen dëmi, apo dëmet që rezultojnë nga ngjarja e siguar. Siguruesi nuk ka përgjegjësi të mëtejshme për ngjarjen e siguar, përveç pagesës së kostove dhe shpenzimeve gjyqësore të ndodhura përpara pagesës që mbulon dëmet që rezultojnë nga ngjarja e sigurimit.

5. Në rast se në kohën e ndodhjes së ngjarjes, apo dëmit ka edhe ndonjë policë tjetër të sigurimit të përgjegjesisë në favor, apo për llogari të të siguarit dhe që zbatohet për këtë ngjarje, siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për dëmshpërblimin e të

to prevent and minimize health damages or other injuries that could lead to compensation claims under the conditions of this insurance policy and comply with all safety measures and technical rules in accordance with applicable legislation.

2. Any event that may lead to a compensation claim under this insurance policy must be reported in writing by the insured to the insurer immediately after the insurance event occurs. As far as possible, no movement or repair should be made until the insurer can conduct an investigation. The insured must immediately notify the insurer of any potential criminal or civil proceedings related to the event and promptly send all relevant documents to the insurer.

3. No admission of liability, promise, offer, or payment should be made without written approval from the insurer. The insurer will have the right to take over and carry out the defense, or the payment of any damages resulting from the insured event, and pursue legal subrogation claims against other parties. The insured must provide all the information and assistance requested by the insurer.

4. The insurer may pay the maximum payable amount for the insured event covered by the insurance policy or a smaller amount sufficient to cover the damage(s) resulting from the insured event. The insurer will have no further liability for the insured event, except for the payment of court costs and expenses incurred before the payment covering the damages resulting from the insured event.

5. If at the time of the event or damage there is another liability insurance policy in favor of or on behalf of the insured that applies to this event, the insurer will not be responsible for compensating the insured except for any excess over the amount payable by the other insurance policy.

siguararit, përveç ndonjë teprice mbi shumën që do të paguhej nga polica tjetër e sigurimit.

X. Parashikime të përgjithshme

1. Këto kushte, çdo shtojcë bashkëngjitur, formulari dhe pyetëtori do të lexohen së bashku si një policë dhe çdo fjalë apo shprehje së cilës i është dhënë një kuptim i vecantë në ndonjë pjesë të kushteve të përgjithshme, të formularit, apo shtojcave, do të mbajë të njëjtin kuptim kudo që mund të paraqitet.

2. Në rast se primi për këtë policë është llogaritur bazuar mbi informacionin e dhënë nga i siguruari, ky duhet të mbajë shënime të sakta që përmbajnë të gjitha detajet dhe brenda një kohe të arsyeshme të lejojë siguruesin për të kryer inspektimin e të dhënave. Pas përfundimit të çdo periudhe të policës, i siguruari duhet t'i japë siguruesit informacionin e saktë të përditësuar, në mënyrë që primi për periudhën në vijim të llogaritet saktë.

3. Siguruesi mund të kryejë inspektime në ambientet e të siguararit. Në rast të konstatimit të një defekti, apo rreziku të dukshëm, për të cilin i siguruari nuk merr masa të menjëhershme për ta eliminuar, siguruesi mund t'i dërgojë të siguararit një njoftim me shkrim nëpërmjet të cilit siguruesi heq përgjegjësinë e tij për dëmet që mund të rezultojnë më vonë nga ky defekt apo rrezik.

4. Në rast se i siguruari konstaton dicka që mund të ndikojë materialisht tek risku i siguarit, ai brenda shtatë ditësh njofton për këtë fakt siguruesin.

5. Shqyrtimi dhe plotësimi i duhur i termave, parashikimeve dhe kushteve, për sa kohë këto lidhen me dicka për t'u kryer apo përmbushur nga i siguruari dhe vërtetësia e të dhënave të tij në pyetësor (që përbën bazën e kësaj police dhe mbahet bashkë me të si pjesë e saj) do të jenë kusht paraprak i çdo përgjegjësie të siguruesit.

X. General Provisions

1. These conditions, any attached appendix, form, and questionnaire will be read together as one policy, and any word or expression given a specific meaning in any part of the general conditions, form, or appendices will hold the same meaning wherever it may appear.

2. If the premium for this policy is calculated based on the information provided by the insured, the insured must keep accurate records containing all details and allow the insurer to inspect the records within a reasonable time. After the end of each policy period, the insured must provide the insurer with the updated accurate information so that the premium for the following period can be calculated accurately.

3. The insurer may conduct inspections at the insured's premises. If a defect or apparent risk is found, for which the insured does not take immediate measures to eliminate, the insurer may send the insured a written notice by which the insurer removes its liability for any damages that may result later from this defect or risk.

4. If the insured discovers something that may materially affect the insured risk, they must notify the insurer within seven days of this discovery.

5. The proper examination and fulfillment of the terms, provisions, and conditions, as long as they relate to something to be done or fulfilled by the insured, and the accuracy of the data provided in the questionnaire (which forms the basis of this policy and is kept with it as part of it), will be a prerequisite for any responsibility of the insurer.

XI. Periudha e policës së sigurimit

Data e fillimit dhe mbarimit të policës së sigurimit përcaktohet në formular.

Njoftimet do të kryhen në adresën e mëposhtme:

SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.

Qendra e Biznesit SIGAL

Blvd. "ZOGU I", Nr. 1, Tirane, Shqiperi

Tel: +355 4 2233308 / 04 2253408 Fax: 04 2250220

E-mail: info@sigal.al ose pasuria@sigal.al

Web: www.sigal.com.al

XI Insurance Policy Period

The start and end date of the insurance policy is determined in the form.

Notifications will be made to the following address:

SIGAL INSURANCE GROUP SH.A.

Qendra e Biznesit SIGAL

Blvd. "ZOGU I", Nr. 1, Tirane, Shqiperi

Tel: +355 4 2233308 / 04 2253408 Fax: 04 2250220

E-mail: info@sigal.al ose pasuria@sigal.al

Web: www.sigal.com.al